



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1206/7 prot.

Tiranë më 14. 7.2022

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 14. 7.2022

PËR KONTROLLUESIN “NOTER AIDA PETOSHATI (SPAHIU)”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Noter Aida Petoshati (Spahiu)” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 101, datë 27.06.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi _____, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë Kontrolluesit u fokusua në trajtimin e ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit të z. _____, administruar me nr. 1206 prot., datë 20.06.2022, nëpërmjet të cilës pretendon se, është njoftuar me një mesazh në platformën e-Albania (në datën 01.03.2022), në llogarinë e tij se “për ju është gjeneruar dokumenti *Certifikatë personale*, nga “punonjësi Aida Petoshati i Dhomës Kombëtare të Noterëve”, pa dijeninë e tij.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi “*Noter Aida Petoshati (Spahiu)*” është person fizik i licencuar nga Ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale sipas ligjit Nr. 110/2018 “*Për Noterinë*”.

Udhëzimi i përbashkët i hartuar nga Komisioneri dhe Ministri i Brendshëm, nr. 463, datë 10.12.2020 “*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin*”, përcakton subjektet kontrolluese që kanë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në regjistrat themeltarë dhe në aktet e Gjendjes Civile. Sipas Aneksit 1, të bashkëlidhur këtij Udhëzimi, këtë akses e kanë edhe subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari “*Noteri*”. Sidoqoftë ky akses nuk është i pakufizuar dhe lidhet me funksionet e secilit kontrollues.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës të paraqitur nga z. _____, nëpërmjet së cilës pretendon se është njoftuar me një mesazh në platformën e-Albania (në datën 01.03.2022), në llogarinë e tij se “*për ju është gjeneruar dokumenti Certifikatë personale, nga “punonjësi Aida Petoshati i Dhomës Kombëtare të Noterëve*”, pa dijeninë e tij, nga shqyrtimi i provave bashkëlidhur ankesës rezultoi se, Kontrolluesi ka gjeneruar dokumentin *Certifikatë personale* për z. _____.

Nga verifikimi i kryer gjatë hetimit administrativ të ushtruar pranë Kontrolluesit, rezultoi se, nuk janë aksesuar apo gjeneruar të dhënat e ankuesit në datën 01.03.2022, nga sistemi e-Albania. Kontrolluesi disponon vetëm kërkesën për informacion të ankuesit (të depozituar me postë pranë zyrës së noterisë), nëpërmjet të cilës është vënë në dijeni se nga llogaria e tij në sistemin e-Albania është gjeneruar *Certifikata personale*.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk provohet që Kontrolluesi të ketë kryer përhapje të të dhënave personale të ankuesit (*Certifikatë personale*), drejt subjekteve të tjera të të dhënave.

3. Në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Ligjit, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit mbi “*Përpunimin e të*

dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk ka hartuar “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 13.07.2022, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, është paraqitur Kontrolluesi, znj. Aida Petoshati (Spahiu), e cila dokumentoj masat e marra për rekuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ si dhe parashitroi këto pretendime:

1. Sa i përket gjenerimit të Certifikatës personale të z. _____, pranoj se mund të ketë ndodhur për arsye të një gabimi njerëzor, për një germë, apo një numër të shtypur gabim, të ID-së së një klienti tjetër ose për shkak të një veprimi noterial, por nga verifikimet që unë kam bërë nuk më rezultojnë të kem përpunuar apo aksesuar të dhënat e ankuesit nëpërmjet sistemit e-Albania;
Kam verifikuar në portalin e-Albania apo dhe në sistemin që regjistron klientët dhe nuk rezultojnë se në datën 28.02.2022, 01.03.2022 dhe 02.03.2022 të jetë gjeneruar certifikatë personale në emër të z. _____ ;

2. Gjenerimi i Certifikatave nga portali e-Albania, kryhet prej meje me qëllim për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, në pamundësi nga ana e tyre për të aksesuar portalin e-Albania;
3. Pas konstatimit të grupit të hetimit, në zyrën e noterisë është vendosur tabela e informimit mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV);
4. Formulari i Njoftimit u plotësua sipas veprimtarisë së zyrës së noterisë.
5. Rregullorja “për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e hartuar.

Sa i përket pretendimit se, Gjenerimi i Certifikatave nga portali e-Albania, kryhet prej meje me qëllim për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është e rëndësishme që çdo Kontrollues (noter) të veprojë në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm “për noterinë”, ligjit “për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve nënligjorë në zbatim të tij.

Në germën “b”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit parashikohet se, mbrojtja e të dhënave personale bazohet “në grumbullimin përpunimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”.

Në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 6 të Ligjit parashikohet si kriter ligjor i përpunimit, të dhënat personale përpunohen vetëm “për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit”.

Në referim të dispozitave të sipërcituara, kontrolluesit që ushtrojnë veprimtarinë në zbatim të ligjit “për noterinë” duhet të mos tejkalojnë qëllimin e përpunimit, sipas parashikimeve në ligjin e tyre të posaçëm.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 pika 1, germa “a/1”, si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të germës “b”, të nenit 5 të Ligjit, të ketë në vëmendje dhe të marrë masa në mënyrë që çdo veprim i kryer nga zyra e tij, të realizohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime dhe në aksesimin në përputhje me këto qëllime;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për aksesimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 6 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të ketë në vëmendje masat e sigurisë në drejtim të garantimit të procesit përpunimit të të dhënave në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen;
6. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 14.7.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

